




REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
 Nr. Prot. 01-1678/14
 Br. Prot. 01-1678/14
 Prot No. 01-1678/14
 Nr. I faq. 02
 Data 14-05-2014
 Broj stranica 02
 Datum 14-05-2014
 Nr. pages 02
 Date 14-05-2014
 PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	14/05/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Arben LOSHI Drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
CC:	znj. Mirjeta BEHLULI u.d. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MPJ-së"



I nderuari z. LOSHI

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MPJ-së" me nr. të prokurimit: MPJ-14-021-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MPJ-së" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MPJ-së” me nr. të prokurimit: MPJ-14-021-221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 25/04/2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti të prokurimit në Dosjen e Tenderit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Dosja e Tenderit”, SEKSIONI II.FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT në pikën 9.1 Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, nënpika 8 kërkohet: Autoservisi jo më larg se 10 km nga Ndërtesa e MPJ-së. Autoriteti Kontraktues nuk duhet krijojë ose imponojë kriterë diskriminuese dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ. Autoriteti Kontraktues me këtë rast ka diskriminuar Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 10 km dhe favorizohen Operatorët Ekonomik që janë më afër se ky kufizim.

Po ashtu në “Dosja e Tenderit”, SEKSIONI II.FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT në pikën 9.1 Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, nënpika 2,3,4,5 kërkohen: Vinça hidraulik për ngritjen e automjeteve - minimum dy (3) vinça (Të dëshmohet me fotografi); Pajisje për riparimin (vullkanizimin) e gomave - (Të dëshmohet me fotografi); Pajisje speciale për diagnostikimin të defekteve të automjeteve. (Të dëshmohet me fotografi); Pajisje speciale për riparimin e klimave të automjeteve.(Të dëshmohet me fotografi). Të gjitha formulimet e lartë cekura që si dëshmi për posedimin e veglave përkatëse kërkohet “Të dëshmohet me fotografi” nuk e dëshmojnë se Operatori Ekonomik ka në posedim këto mjete. Autoriteti Kontraktues për pozicione të tilla duhet të kërkoj deklarata të veglave, hapësirave ose pajisjeve teknike në dispozicion të tenderuesit që ofron shërbimet.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me, nenin 7 Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi dhe nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, si dhe Pika 23.6 Kriteret e përzgjedhjes që mund të përdorën nga AK i Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !